



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
DEPARTAMENTI I ADMINISTRATËS PUBLIKE
DREJTORIA E PROCEDURAVE TË REKRUTIMIT NË SHËRBIMIN CIVIL

Lënda: Kthim përgjigje

ZNJ. DUDI ILIAS

Në përgjigje të emailit tuaj, përmes së cilës referuar ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e Informimit”, kërkoni informacion mbi numrin total të përfituesve të Fondit të Ekselencës nëpërmjet programit të punësimit të përkohshëm të studentëve të ekselencës për periudhën 26.12.2018-16.05.2022, ju sqarojmë si më poshtë:

Ndër ristë e vitit 2019 ishte edhe iniciativa për punësim të përkohshëm me kontratë një vjeçare në institucionet e administratës shtetërore, të studentëve që kanë përfunduar studimet e ciklit të parë, të dytë ose të tretë të arsimit të lartë me notë mesatare 9.00 – 10.00 (studentët e ekselencës). Kështu, në fund të vitit 2018, në kuadër edhe të paktit me universitetin u miratuan dy vendime, konkretisht vendimin nr. 766, datë 26/12/2018, për punësimin në institucionet e administratës shtetërore, pjesë e shërbimit civil dhe vendimin nr. 812, datë 26/12/2018, për punësimin në institucionet e administratës shtetërore, jashtë shërbimit civil, vendime të cilët përfaqësonin bazën e nevojshme ligjore për krijimin e mundësive për studentët e ekselencës për t’u emëruar në mënyrë të përkohshme në administratën shtetërore. Synimi i kësaj iniciative ishte dhënia e mundësisë për studentët e ekselencës për të krijuar eksperiencat e nevojshme e, si rrjedhim, vendosja më pas në pozita të barabarta me kandidatë të tjerë në procedurat e konkurrimit, për sa i përket aftësive që fitohen nëpërmjet punës.

Në këtë kuadër, në gusht të vitit 2019, Këshilli i Ministrave miratoi vendimin nr. 586, datë 30/08/2019, “Për punësimin e përkohshëm të studentëve të ekselencës në institucionet e administratës shtetërore”.

Sipas këtij vendimi, nga kjo iniciativë përfitojnë studentët të cilët kanë përfunduar studime universitare: (i) në secilin prej cikleve të arsimit të lartë me mesatare 9.00 – 10.00 ose ekuivalent, në institucionet e arsimit të lartë jashtë Shqipërisë, institucionet e akredituara të arsimit të lartë publik në Republikën e Shqipërisë apo institucionet/programet e akredituara të arsimit të lartë jopublik në Republikën e Shqipërisë; (ii) jo më shpejt se 3 (tre) vite përpara vitit kalendarik për të cilin po zhvillohet procedura.

Studentët e ekselencës do të kenë mundësi të punësohen në pozicione pune “specialist” në institucionet e administratës shtetërore në kuptim të ligjit nr. 90/2012, me përjashtim të: (i) njësisve të drejtpërdrejta të ofrimit të shërbimeve në fushën e shëndetësisë, arsimit, artit dhe kulturës; (ii) Policisë së Shtetit (punonjësit me statusin e policisë së shtetit); (iii) Shërbimit



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
DEPARTAMENTI I ADMINISTRATËS PUBLIKE
DREJTORIA E PROCEDURAVE TË REKRUTIMIT NË SHËRBIMIN CIVIL

diplomatik (punonjësit me grada diplomatike); (iv) Forcave të Armatosura (punonjësit me grada); (v) Institucioneve që aplikojnë sisteme të tjera me grada (punonjësit me grada).

Numri i pozicioneve të punës që ju ofrohen ekselentëve për çdo vit kalendarik, nuk do të jetë më i madh se një e treta e numrit të pozicioneve të institucionit. Në këtë mënyrë sigurohet funksionimi normal i institucioneve për realizimin e detyrave të tyre, si dhe balancimi midis nëpunësve me përvojë dhe ekselentëve, të cilët synojnë të krijojnë eksperiencë të vlefshme dhe të përfitojnë njohuritë e duhura.

Procedura që do të ndiqet për punësimin e ekselentëve është një procedurë konkurrese, që përfshin grumbullimin e pikëve në bazë të: (i) mesatares së ponderuar; (ii) nivelit të diplomës dhe vendit ku është kryer studimi dhe universitetit; (ii) angazhimeve të kandidatëve në aktivitete ekstrakurrikulare, vullnetarizmit dhe skemave të mobiliteti.

Pas vlerësimit të dokumentacionit të tyre, ekselentët për zgjedhin pozicionet e punës bazuar në renditjen me pikë, dhe brenda grupit të pozicioneve që përshtatet me fushën dhe nivelin e tyre të studimit, duke përcaktuar gjithashtu edhe një metodologji të përcaktimit të rradhës së përzgjedhjes së pozicionit të punës, në rastin kur kemi ekselentë me pikë të barabarta.

Studentët e ekselencës përfitojnë vetëm një herë nga skema e punësimit sipas procedrave të këtij vendimi, me qëllim krijimin e hapësirave për të gjithë studentët e ekselencës.

Në përfundim të kontratës 1 vjeçare të punës, nëse këta ekselentë do të dëshirojnë të jenë pjesë e administratës publike në pozicione të shërbimit civil ose me kod pune, do të duhet t'i nënshtrohen procedurave të rekrutimit të përcaktuara në bazë të legjislacionit specifik të rregullimit të marrëdhënies së punës.

Në vijim të bazës ligjore të cituar më sipër, gjatë vitit 2019 u zhvilluan dy raunde të punësimit, konkretisht gjatë katërmujorit të parë dhe katërmujorit të fundit të vitit, ku u emëruan me kontratë të përkohëshme 1 vjeçare gjithsej **602 ekselentë**.

Për thirrjen e tretë që u zhvillua në vitin 2020, u emëruan me kontratë të përkohëshme 1 vjeçare gjithsej **92 ekselentë**.

Në vijim, u miratua Vendimi nr. 665, datë 10/11/2021, i Këshillit të Ministrave, “Për një shtesë një vendimin nr. 586, datë 30/08/2019, të Këshillit të Ministrave, “Për punësimin e përkohshëm të studentëve të ekselencës në institucionet e administratës shtetërore”, të ndryshuar”.

Sipas këtij vendimi, të gjithë atyre të përzgjedhurve nëpërmjet platformës “Gati për Shqipërinë”, ku aplikuan të gjithë ata që donin të kontribuonin në sfidat e mandatit të tretë të qeverisë shqiptare, përjashtimit për vitin 2021, ju jepej e drejta të përzgjidhnin dhe të sistemoheshin me prioritet në pozicionet e dedikuara për studentët e ekselencës.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
DEPARTAMENTI I ADMINISTRATËS PUBLIKE
DREJTORIA E PROCEDURAVE TË REKRUTIMIT NË SHËRBIMIN CIVIL

Këta të përzgjedhur, sipas vendimit, duhet të plotësonin të njëjtat kritere të “studentëve të ekselencës”, pra: (i) të kishin notë mesatare 9.00 – 10.00; (ii) të ishin të diplomuar jo më herët se 3 (tri) vite përpara vitit kalendarik për të cilin po zhvillohej procedura; (iii) diploma të ishte në përputhje me kriterin e nivelit dhe llojit të diplomës që kërkonin pozicionet e dedikuara për ta.

Gjithashtu, sipas vendimit procedura e përzgjedhjes që do të zhvillohej për këta kandidatë do të ishte e njëjtë me atë të përcaktuar në vendimin aktualisht në fuqi, pra vlerësimi me pikë dhe mënyra se si kandidatët do të përzgjidhnin pozicionet sipas pikëve që do të grumbullonin.

Në vijim të bazës ligjore të cituar më sipër, gjatë vitit 2022 u zhvilluan thirrja për të përzgjedhurit e platformës “Gati për Shqipërinë”. Në përfundim të këtij procesi u emëruan me kontratë të përkohëshme 1 vjeçare gjithesej **42 ekselentë**.

Më poshtë në format tabelare do të gjeni informacionin e kërkuar

Thirrja e I për Punësimin e përkohshëm të Ekselentëve	
Institucioni Arsimor	Numri i Ekselentëve
Akademia Profesionale e Biznesit	1
City University of London	1
Ege University Turqi	1
Fresno Pacifik University Californi	1
International University of Struga Maqedoni	1
KDI School of Publikc Policy and Managment, South Corea	1
Kolegji Universitar "Bedër"	1
Kolegji Universitar "I Biznesit"	2
Kolegji Universitar "LOGOS"	1
Kolegji Universitar "Luarasi"	8
LCC International University Lituani	1
Universiteti "Aleksandër Moisiu", Durrës	6
Universiteti "EPOKA"	6
Universiteti "Eqrem Çabej", Gjirokastrë	2



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
DEPARTAMENTI I ADMINISTRATËS PUBLIKE
DREJTORIA E PROCEDURAVE TË REKRUTIMIT NË SHËRBIMIN CIVIL

Universiteti "Fan S. Noli", Korçë	6
Universiteti "Ismail Qemali", Vlorë	20
Universiteti "Luigj Gurakuqi", Shkodër	16
Universiteti "Marin Barleti"	2
Universiteti "Mesdhetar i Shqipërisë"	8
Universiteti Andrassy Gyula Budapest	1
Universiteti Bujqësor i Tiranës	21
Universiteti European i Tiranës	9
Universiteti HAIFA, Izrael	1
Universiteti i Arteve	7
Universiteti i Bolonjës	1
Universiteti i Elbasanit "Aleksandër Xhuvani"	11
Universiteti i Mjekësisë, Tiranë	19
Universiteti i New York-ut në Tiranë	3
Universiteti i Romës "Tor Vergata"	1
Universiteti i Tiranës	274
Universiteti Jena Gjermani	1
Universiteti Metropolitan Tirana	1
Universiteti Polis	5
Universiteti Politeknik i Tiranës	14
Universiteti Privat "Albanian University"	5



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
DEPARTAMENTI I ADMINISTRATËS PUBLIKE
DREJTORIA E PROCEDURAVE TË REKRUTIMIT NË SHËRBIMIN CIVIL

Thirrja e II për Punësimin e përkohshëm të Ekselentëve	
Institucioni Arsimor	Numri i Ekselentëve
Bilkent University, Turkey	1
Georgetown University	1
Kolegji Universitar "Luarasi"	1
Peoples' Friendship University of Russia	2
Università degli Studi di Perugia	1
Universitatea Politehnica din București	2
Universiteti "Aleksandër Moisiu", Durrës	5
Universiteti "Aleksandër Xhuvani", Elbasan	2
Universiteti "EPOKA"	2
Universiteti "Eqerem Çabej", Gjirokastrë	1
Universiteti "Fan S. Noli", Korçë	1
Universiteti "Ismail Qemali", Vlorë	9
Universiteti "Luigj Gurakuqi", Shkodër	6
Universiteti "Metropolitan Tirana"	1
Universiteti Bujqësor	8
Universiteti Evropian i Tiranës	3
Universiteti i Arteve	1
Universiteti i Mjekësisë, Tiranë	3
Universiteti i New York-ut në Tiranë	1
Universiteti i Tiranës	72
Universiteti Polis	2
Universiteti Politeknik	16
Universiteti Privat "Albanian University"	1
University of Food Technology, Bulgaria	1

Thirrja e III për Punësimin e përkohshëm të Ekselentëve

Institucioni Arsimor	Numri i Ekselentëve
Abant Izzet Baysal University, Turkey	1
International University of Struga, North Macedonia	1
Kolegji Universitar "I Biznesit"	1
Kolegji Universitar "Luarasi"	4
Ovidius University of Constanta, Rumani	1
Tirana Business University College	1
Università degli Studi di Camerino	1
Universiteti "Aleksandër Moisiu", Durrës	2
Universiteti "Aleksandër Xhuvani", Elbasan	4
Universiteti "Fan S. Noli", Korçë	1
Universiteti "Ismail Qemali", Vlorë	5
Universiteti "Luigj Gurakuqi", Shkodër	3
Universiteti Bujqësore	4
Universiteti European i Tiranës	5
Universiteti i Arteve	1
Universiteti i Mjekësisë, Tiranë	2
Universiteti i Tiranës	49
Universiteti Polis	1
Universiteti Politeknik	3
Universiteti Privat "Albanian University"	1
University of Pennsylvania, USA	1



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
DEPARTAMENTI I ADMINISTRATËS PUBLIKE
DREJTORIA E PROCEDURAVE TË REKRUTIMIT NË SHËRBIMIN CIVIL

Punësimi i përkohshëm i Ekselentëve, nga platforma "Gati për Shqipëri"

Institucioni Arsimor	Numri i Ekselentëve
Kolegji Universitar "Instituti Kanadez i Teknologjisë"	1
Kolegji Universitar Wisdom	1
Universiteti "Fan.S.Noli" Korçë	2
Universiteti Bujqësor i Tiranës	2
Universiteti European i Tiranës	1
Universiteti i Arteve	1
Universiteti i Shkodrës, Luigj Gurakuqi	2
Universiteti i Tiranës	29
Universiteti Mesdhetar i Shqipërisë	1
Universiteti Ismail Qemali Vlorë	1
Universiteti i Torinos	1